



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
SEKRETARIATI

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Komisioni i Arsimit

Datë 3.03.2026

Lenda: PËR NJË SHITESË TË VENDIMIT NR.53, DATË 20.11.2025, PËR MIRATIMIN E BURSIVE PËR NXËNËSIT QË NDJEKIN ARSIMIN ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026”.

Analiza ligjore:

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit Nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 2 të nenit 32, të Ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 2 të Ligjit Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të nenit 8 të Ligjit Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit” të ndryshuar, të Ligjit Nr. 626, datë 22.06.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të Ligjit Nr. 9355, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” të ndryshuar, të VKM-së Nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të vecanta në institucionet arsimore parauniversitare publike” të ndryshuar, të Shkresës së Ministrisë së Arsimit, me nr.7094/1 prot., datë 06.11.2025, për planin e bursave për Bashkinë Kavajë për vitin mësimor 2025-2026, të cilat do të mbulohen nga fondet e bashkisë.

Situata aktuale e funksionit:

Drejtoria ligjore në bashkëpunim me drejtoritë e burimeve ekonomike dhe atë të shërbimit social ka hartuar relacionin dhe me miratimin e kryetarit të bashkisë i propozon këshillit bashkiak

1. Të miratojë 1 bursë të plotë për nxënësin për vitin shkollor 2025-2026, që ndjek mësimet në **Shkollën 9-vjeçare “3 Dëshmorët”, Kavajë**, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër	Klas a	Lloji bursës	Kriteri (Pika, gërma e VKM)
1.	Greis Sulejman Merkja	II	Bursë e Plotë	Pika 2.3, gërma g

2. Të miratojë 1 bursë të plotë për nxënësin për vitin shkollor 2025-2026, që ndjek mësimet në **Shkollën 9-vjeçare “Mehmet Babamusta” Kavajë**, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër	Klas a	Lloji bursës	Kriteri (Pika, gërma e VKM)
-----	--------------	-----------	--------------	--------------------------------

Pas miratimit të këtij projekt-vendimi, një kopje e tij të dërgohet pranë drejtorive të shkollave përkatëse ku ndjekin studimet nxënësit dhe një kopje pranë Zyrës Arsimore Kavajë.

Impakti Financiar:

Fondet e bashkisë Kavajë.

Drejtoria/Spektori pergjegjes:

Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Burimeve Ekonomike dhe Drejtoria e Shërbimit Social

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria përkatëse dhe Këshilli Bashkiak Kavajë

Impakti social/grupet qe preken:

Studentët sipas tabelave dhe kategorive.

A eshte objekt konsultimi:

Jo

Komisioni i perhershëm i Arsimit u mbledhë më datë 03.3.2026 dhe shqyrtoi projekt-vendimin e lartëpërmendur bashkë me relacionin dhe dokumentat shoqërues te tij.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozoje Keshillit bashkiak:

- Kalimin e projektaktit ne mbledhjen e Keshillit per vleresimin e metejshem dhe per shqyrtim
- Miratimin e projekt aktit
- Refuzimin e miratimit te projektaktit
- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:

Anëtarët e Komisionit

Valbona Mustafa

Kryetar

Meleqe Kazazi

Nen/Kryetar

Shqipe Baulja

Anetar

Rovina Aliaj

Anetar

Enea Stefa

Anetar